

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6301
E martë, 27 prill 2021
çmimi 0.40 €

Themelohet Komiteti Ndërmintor për Kompleksin Memorial "Adem Jashari"



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TË HËNËN ËSHTË MBAJTUR DEBATI PARLAMENTAR PËR MENAXHIMIN
E PANDEMISË COVID-19 | FAQE 4-5

OPOZITA: QEVERIA DËSHTOI TA MENAXHOJË PANDEMINË



Subjektet opozitare kanë vlerësuar se Qeveria e Kosovës ka dështuar ta menaxhojë pandeminë Covid-19. Në seancën parlamentare të thirrur për të

diskutuar për gjendjen e pandemisë, liderët opozitarë kanë thënë se kryeministri Albin Kurti ka dështuar për sigurimin e vaksinës kundër

Covidit. Sipas tyre, prioritet politik i kryeministrit gjatë kësaj kohe ishin zgjedhjet parlamentare në Shqipëri dhe jo shëndeti i qytetarëve të Kosovës

OPINION

ARSYEJA E MBETJES SË FORCËS GRAVITACIONALE JASHTË MODELIT STANDARD TË FIZIKËS SË GRIMCAVE

F. 8

Nga: Naim
KRASNIQI, fizikan



AKTUALE



HAXHIU: GJATË DY DEKADAVE KA MUNGUAR VULLNETI POLITIK PËR ADRESIM TË KRIMEVE TË LUFTËS F. 7

SPECIALJA UA VAZHDON PARABURGIMIN HYSNI GUCATIT DHE NASIM HARADINAJT F. 3

EKONOMI

KURTI: GJATË MANDATIT QEVERISËS DO TË MUNDËSOHET BANIM I PËRBALLUESHËM PËR 4 000 FAMILJE F. 9

KEDS-I FILLON INVESTIMET MASIVE NË RRJETIN ELEKTRIK TË KLINËS F. 9

SPORT


MINISTRI ÇEKU: SHTATORJA E VOKRRIT PËRURORHET MË 9 QERSHOR F. 9

FERONIKELI DHE ARBËRIA LUFTOJNË PËR MBIJETESË F. 9

BORRELLI PRET MARRËVESHJE TË SHPEJTË NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË | FAQE 3



VAZHDON NUMËRIMI I VOTAVE NË SHQIPËRI, PRIN PS-ja | FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vazhdon numërimi i votave në Shqipëri, prin PS-ja

Nga rezultatet e deritanishme të zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri, Partia Socialiste kryeson me 48.93 për qind të votave, Partia Demokratike me 39.38 për qind dhe Lëvizja Socialiste për Integrim me 6.94 për qind të votave. Ndërkaq PSD-ja e Tom Doshit ka marrë 2.16 për qind të votave



TIRANË, 26 PRILL - Në Shqipëri ka filluar procesi i numërimit të votave që nga orët e para të mëngjesit të së hënës dhe deri në orën 17:21, sipas raportimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë numëruar 2 961 kuti, nga 5 199 në total në rang vendi.

Nga rezultatet e deritanishme, kryeson Partia Socialiste me 48.93 për qind të votave, Partia Demokratike me 39.38 për qind dhe Lëvizja Socialiste për Integrim me 6.94 për qind të votave. Ndërkaq PSD-ja e Tom Doshit ka marrë 2.16 për qind të votave.

Në këto zgjedhje si kandidatë të pavarur garuan edhe tre anëtarë të Degës së Lëvizjes Vetëvendosje në Shqipëri. Boiken Abazi, sipas rezultateve të deritanishme, ka fituar 0.12 për qind të votave, Iljaz Shehu 0.03 për qind dhe Kreshnik Merxhani 0.01 për qind.

Nga selia e Partisë Socialiste, kandidatja për deputete, Bora Muzhaqi, përcollti një mesazh për, siç tha ajo, rivalin politik, duke thënë se ata po vonojnë procesin e numërimit të votave. "Qytetarët meritojnë ta mësojnë një orë e më parë rezultatin përfundimtar. Kjo ishte ndeshje shumë e rëndësishme - dyvizionesh

dhe dy platformash kaq të ndryshme që kanë ndezur për javë të tëra debate në publik. Ata janë shprehur qartë, dhe partitë tani kanë nevojë t'u shërbejnë për nxjerrjen e rezultatit", ka thënë ajo, duke bërë vërejtje në, siç tha Muzhaqi, kërkesat e shpeshta për pushim të komisionarëve të PD-së.

Ndërsa kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka shprehur optimizëm për fitoren e partisë të cilën ai udhëheq. Ai tha se deri më tani janë numëruar votat e partisë në pushtet, ndërsa theksoi se PS-ja ka pësuar humbje në bastionet e saj. "Siç e dimë të gjithë, qendrat e para që numërohen janë përcaktuar nga partia në pushtet dhe favorizojnë partinë në pushtet. PS ka humbur thellë në votat e numëruara në Përmet, Këlcyrë e Memaliaj. Kemi të bëjmë me humbje të thellë të PS dhe rritje të votave për PD e koalicionin për ndryshim. Ky është fillimi. Pas kutive ku janë ndëshkuar, zona 10 në Tiranë ku PD ka rritje 30 për qind, apo në Memaliaj, Këlcyrë e Përmet do të vijë dhe radha e kutive të tjera. Derisa janë ndëshkuar në bastione presim që vota të

ndryshojë", ka thënë Basha. Në anën tjetër, ambasadorja amerikane, Yuri Kim, pasi vizitoi një qendër të numërimit të votave, u bëri thirrje kandidatëve dhe udhëheqësve politikë që të presin me qetësi rezultatin e zgjedhjeve. "Detyra e kandidatëve dhe udhëheqësve politikë është që ta presin të qetë dhe me durim rezultatin. Në entuziazmin e momentit disa kanë shpallur fitoren, mirëpo nuk kemi mbërritur ende aty sa të dalë rezultati përfundimtar", u shpreh ambasadorja.

Përfaqësuesi i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Luigi Soreca, bëri thirrje që askush të mos dalë në përfundime pa u numëruar edhe vota e fundit. Ai bëri thirrje që procesi të vijojë pa probleme dhe pa vonesa. "Po shkoj në disa qendra numërimi dhe në disa prej tyre ekipet po bëjnë pushim që të rifillojë sërish. Procesi duhet të vijojë pa probleme dhe vonesa sepse kemi shumë gjëra për të mësuar dhe qytetarët duan ta mësojnë rezultatin. Zgjedhësit shqiptarë e dhanë votën e tyre, ka pasur


pjesëmarrje të lartë dhe ky është tregues i jetës demokratike në Shqipëri", u shpreh Soreca.

Komisioni Qendror Zgjedhor ka vlerësuar se i duhen 48 orë për ta përcaktuar fituesin preliminar të zgjedhjeve të 25 prillit për 140 mandatet në 12 qarqe, ku përfshihen 61 bashki, të ndara në 92 Zona të Administrimit Zgjedhor. "Askush nuk e di se kush i ka fituar zgjedhjet. Duhet të presim 48 orë", tha Komisionari Shtetëror i Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, në një paraqitjeje publike, menjëherë pas mbylljes zyrtare të votimit ditën e diel. Pra, rezultati preliminar për

zgjedhjet e 25 prillit pritet të bëhet i ditur zyrtarisht ditën e martë. Në këto zgjedhje, për ta reformuar sistemin e saj zgjedhor, Shqipëria ka investuar në infrastrukturë duke pajisur një pjesë të vendvotimeve me votim elektronik. Në zgjedhjet e përgjithshme të Shqipërisë të drejtë vote kishin 3.6 milionë qytetarë. Qytetarët votuan për të zgjedhur 140 deputetët e parlamentit të ri dhe qeverinë e re që do ta udhëheqë vendin për katër vjetët e ardhshëm.

Në Shqipëri të dielën u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, për herë të dhjetë që nga nisja e pluralizmit politik dhe rënia e komunizmit në vend. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 48.59 për qind, përkatësisht 1 729 834 qytetarë.

Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore. Për krijimin e qeverisë, partia apo koalicioni fitues duhet të ketë së paku 71 mandate në Kuvendin e Republikës.



Shqipëria

Vota të numëruara: 902658

	Përqindja	Mandate
PS	48.93%	72
PD-AN	39.38%	52
LSI	6.94%	4
PSD	2.16%	1
NTH	0.62%	0
TË TJERË	1.96%	0

Buzimi.KOZ / Përditësimi 18:23:02

Komisioni Evropian deklarohet kundër ndryshimit të kufijve në Ballkan

PRISHTINË, 26 PRILL - Zëdhënësi kryesor i Komisionit Evropian, Eric Mamer, ka thënë të hënën, në një konferencë për media, se qëndrimi i Bashkimit Evropian rreth ideve për ndryshimin e kufijve në rajonin e Ballkanit Perëndimor është i qartë dhe se nuk ka nevojë për asnjë ndryshim kufijsh.

Ai i ka bërë këto deklarata kur është pyetur se cili është qëndrimi i presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, rreth ideve për ndryshim të kufijve, qoftë



përmes dyshimeve se për këtë ka pasur një "non paper" slloven, apo ideve të tilla që qarkullojnë nëpër qarqe të ndryshme. "Përveç letrës që përmendet, e së cilës i

referohen shumë e ne nuk e kemi parë, nuk jemi në dijeni për idetë e tjera për këtë dhe e dini shumë mirë pozicionin e qartë të BE-së që e kemi përsëritur shumë herë. Ne

nuk jemi në asnjë mënyrë në favor të çfarëdo ndryshimi të kufijve. Duhet ta lëmë këtë çështje të mbyllur një herë e përgjithmonë. Pa marrë parasysh se a kanë ardhur letra, a do të vijin letrat apo jo, qëndrimi ynë është shumë i qartë në këtë çështje", ka thënë zëdhënësi i Komisionit Evropian, Eric Mamer.

Tash e më shumë se një javë, mediat në rajon, por edhe më gjerë, kanë shkruar për idetë për ndryshimin e kufijve të vendeve në rajonin të Ballkanit si mundësi për t'i zgjidhur çështjet e mbetura si

të pazgjidhura nga procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Mediat në Bosnje e Hercegovinë dhe në Slloveni kanë shkruar se për këto ide kryeministri slloven Janez Jansha, vendi i të cilit merr së shpejti edhe kryesimin e radhës të BE-së, kishte dorëzuar një "non paper" me këtë ide. Por, në BE kanë thënë disa herë se "nuk e kanë parë një letër të tillë". Disa shtete të BE-së, e më së shumti Gjermania, janë shprehur kundër ideve të tilla duke i quajtur të rrezikshme.



TË HËNËN ËSHTË MBAJTUR DEBATI PARLAMENTAR PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË COVID-19

Opozita: Qeveria dështoi ta menaxhojë pandeminë

Subjektet opozitare kanë vlerësuar se Qeveria e Kosovës ka dështuar ta menaxhojë pandeminë Covid-19. Në seancën parlamentare të thirrur për të diskutuar për gjendjen me pandeminë, liderët opozitarë kanë thënë se kryeministri Albin Kurti ka dështuar për sigurimin e vaksinës kundër Covidit. Sipas tyre, prioritet politik i kryeministrit gjatë kësaj kohe ishin zgjedhjet parlamentare në Shqipëri dhe jo shëndeti i qytetarëve të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 26 PRILL - Liderët opozitarë e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti për mungesë përgjegjësie për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Në seancën parlamentare të thirrur nga opozita, ku është debatuar për menaxhimin e pandemisë, ata kanë thënë se qeveria ka braktisur qytetarët në kohën kur ata kanë pasur më së shumti nevojë për mbështetje. Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se në vend që të merret me sigurim të vaksinës, kryeministri Kurti është marrë me ushtrimin e

shtetësisë së dyfishtë duke marrë pjesë në zgjedhjet e një vendi fqinj. "Ka qenë e udhës që këtë debat ta ftonte qeveria, sepse kur jam takuar me kryeministrin në ardhje, Kurtin, ka thënë që për pesë tema do të diskutojmë me opozitën. Dialogun, sigurinë nacionale, pandeminë dhe arsimin. Ne nuk e ftuam këtë debat që t'u shpjegojmë qytetarëve se kjo qeveri i ka braktisur ata. Qytetarët po ndihen të vetmuar pa mbështetje në përballje me virusin. Qytetarët e kanë parë se qeveria ka prioritet të tjera", ka thënë Hoxhaj. Ai e ka pyetur kryeministrin Kurti i cili nuk ishte i pranishëm në këtë seancë nëse a ka

siguruar ndonjë vaksinë për qytetarët. "Nuk ka ndodhur askund që kryeministri i vendit merret me ushtrimin e shtetësisë së dyfishtë. Kur u votua qeveria, Kurti u zotua që deri në fund të vitit do të vaksinohet 60 për qind të popullatës. Sot mund të them se vetëm 1 për qind e popullatës është vaksinuar përdërisa nuk kemi më vaksina. Në botë jemi më të fundit sa i përket vaksinës. Një qeveri e përgjegjshme do të duhej ta nxirrte Kosovën nga kjo valë e dështimit dhe vdekjeve të njerëzve. Shiheni Shqipërinë dhe Maqedoninë. Vetëm Bosnja dhe Kosova kanë siguruar zero vaksina vetë, nuk po flasim për ndihma. Prandaj po pyesim se ku është kjo qeveri? Mos iu kanë ngatërruar kabllot kësaj qeverie? As nuk po duan, as nuk po dinë e as nuk po duan të mësojnë", ka thënë Hoxhaj. Më tej, Hoxhaj ka shtuar se qytetarët e Kosovës aleatë të vetëm në pandemi kanë Zotin dhe fatin. "Duhet ta dijë çdokush që njerëzit janë lodhur nga pandemia dhe çdo individ që përballet me virusin nuk ka aleat tjetër përveç Zotit dhe fatit. Nuk e ka krah qeverinë. Prandaj ne e ftuam këtë debat që qeveria të reflektojë menjëherë. Për të parë cili

është plani i saj për ta vaksinuar popullatën. Ne e thirrëm këtë seancë t'i themi Kurtit që të mos dorëzohet nga përgjegjësia që ka", ka deklaruar Hoxhaj. Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka qenë i ashpër në kritika ndaj kryeministrit Albin Kurti për pjesëmarrje në zgjedhjet e Shqipërisë. Ai ka thënë se Kurti për dy javë ka vizituar Shqipërinë katër herë, kurse Klinikën Infektive asnjëherë. "Kjo pamje tregon për rëndësinë dhe përgjegjësinë që kjo qeveri ia kushton pandemisë. Çdo dy orë një qytetar i Kosovës vdes për shkak të pandemisë. Nuk pres që ju si klasë politike të bëni mrekulli menjëherë, por ta kuptoni seriozitetin e kësaj ngjarjeje. Pres nga kryeministri të vijë këtu. Kryeministri ynë nuk po përpiqet fare, është zhdukur, është humbur. Kur çdo dy orë vdes një qytetar në Kosovë, kryeministri ynë shpërndan fletushka në Lezhë e Tiranë, merreni me mend. Për dy javë ka vizituar Shqipërinë katër herë e Klinikën Infektive asnjëherë", është shprehur ai, duke shtuar. Sipas tij, për kryeministrin më i vlefshëm është Boiken Abazi se 1 000 pacientë. "I bëj thirrje që

punën e parë çdo mëngjes ta nisë nga QKUK-ja. 1 000 pacientë për një Boiken nuk ia vlen, as ai s'i ka aq vota. Dilu zot kryeministër, ty të kanë prijës. Përpiqu, edhe kur nuk mundesh, së paku përpiqu", ka deklaruar Abdixhiku. Kurse lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka kritikuar masat e reja qeverisë. Sipas tij, masat kundër Covidit duhet të lirohen edhe më në mënyrë që t'u lejojnë bizneseve të punojnë. "Ndalini presionet ndaj bizneseve dhe gjobat ndaj qytetarëve. Kjo nuk është praktikë e duhur në kohë krizë. Merrni kredi të buta, veproni me urgjencë dhe mos i zbrisni pagat, pensionet dhe shtesat. Legalizoni të gjitha tregjet që sjellin të hyra në buxhet", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se duhet të hiqet edhe ora policore. "Përkrahni komunat, mos ua hiqni projektet. Keni filluar keq duke ua ndërprerë projektet. Hapni gastronominë dhe lejoni sallat e mëdha. As ajo salla e dasmave nuk është më e madhe se kjo këtu në Kuvend. Hapini sallat me masa mbrojtëse. Hiqeni orën policore, sepse ua vështirëson jetën qytetarëve", ka deklaruar Haradinaj.

Borrelli pret marrëveshje të shpejtë në mes të Kosovës dhe Serbisë

Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian (BE) për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, në një konferencë të përbashkët në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka shprehur bindjen se dialogu do të vazhdojë në muajin maj, me një takim ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq. “Po bëjmë çmos për ta vazhduar dialogun. Shpresoj që më 11 maj të kemi një takim”, ka treguar Borrelli



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 PRILL - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian (BE) për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka thënë se pret që sa më shpejt të arrihet një marrëveshje për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës e Serbisë sado e vështirë që të duket arritja e saj. Këto komente ai i bëri të hënën në një konferencë të përbashkët në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Borrell ka shprehur bindjen se dialogu do të vazhdojë në muajin maj, me një takim ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq. “Po bëjmë çmos për ta vazhduar dialogun dhe shpresoj se më 11 maj do të

kemi një takim”, është shprehur ai.

Borrell ka thënë se e vlerëson përkushtimin e presidentit Vuçiq për dialogun me Kosovën për të arritur deri te një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërish obliguese. “Pres arritjen sa më të shpejtë të marrëveshjes, pa marrë parasysh vështirësitë”, ka deklaruar Borrell.

Në Bruksel këtë javë do të qëndrojë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi dhe ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla. Borrell ka shtuar se për rrugëtimin e Serbisë drejt BE-së janë tri kushte kryesore: normalizimi i raporteve me Kosovën, sundimi i ligjit dhe që Serbia të përshtatë me qëndrimin e BE-së politikën e saj të jashtme.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se Serbia është e gatshme për një dialog konstruktiv. Ai ka thënë se Serbia do të punojë për ta përmirësuar atmosferën për arritjen e marrëveshjes. “Nuk mundemi vetëm të vazhdojmë të punojmë dhe duke u takuar, por duhet të arrijmë një rezultat substancial”, ka thënë Vuçiq.

Ndërkaq sa i përket përshtatjes me qëndrimet e BE-së të politikës së jashtme, Vuçiqi tha se “Serbia është në një pozitë të vështirë për shkak të Kosovës” dhe se “në

të ardhmen do të bëjë përpjekje për ta rritur përshtatjen me qëndrimet e BE-së”.

BE-ja e ka ngritur këtë çështje për shkak se Serbia, vend që synon anëtarësimin në bllokun evropian, mbështet më shumë Rusinë dhe Kinën në politikën e jashtme sesa BE-në. “Nëse dëshironi të bëheni anëtare e BE-së, duhet t’i ndani edhe vlerat e BE-së”, është shprehur Borrelli, duke shtuar se BE-ja është e përkushtuar tërësisht për perspektivën evropiane për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. “BE-ja pret nga

Serbia që të japë rezultate në reforma, e posaçërisht në sundimin e ligjit dhe lirinë e mediave”, është shprehur shefi i diplomacisë evropiane. Në kornizën negociuese të BE-së për Serbinë është përfshirë edhe kushti për normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve me Kosovën, përfshirë edhe përmes një dokumenti ligjërish obligues. Prandaj, BE-ja edhe një herë ka përsëritur se procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është kusht për të dyja palët, që të avancojnë edhe në rrugëtimin e tyre përkatës evropian.

Specialja ua vazhdon paraburgimin Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

PRISHTINË, 26 PRILL - Përmes vendimeve të publikuara në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) në Hagë është bërë me dije se gjykatësi paraprak, Nicolas Guillou, ua ka vazhduar masën e paraburgimit Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Të dy po akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë për kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. “Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara,



ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm),

në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes

shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale. Z. Gucati dhe z.

Haradinaj bënë akuza dhe komente nënçmuese kundër dëshmitarëve (të mundshëm) dhe në mënyrë të përsëritur shprehën synimin e tyre për ta dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara. Me këto veprime, z. Gucati dhe z. Haradinaj shkelën fshehtësinë e procedurës dhe frikësuan dëshmitarë (të mundshëm) të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe, si pasojë, penguan punën dhe hetimet e ZPS-së”, thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës. “Në bazë të ligjit, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë juridiksion që të gjykojnë individë për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë kur këto vepra penale kanë të bëjnë me procedurat zyrtare dhe zyrtarë të Dhomave të Specializuara”, thuhej më tutje në njoftim.



Vitia: Kemi ulje të rasteve të reja dhe të viktimave

Kritikave të opozitës për pandeminë i është përgjigjur ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia. Ai ka vlerësuar se gjendja në sektorin e shëndetësisë është nën kontroll dhe me tendencë përmirësimi.

Duke përmendur prioritetet e tij, ai ka treguar se në fillim të mandatit të tij shifrat e vdekjeve dhe infektimit ishin më të larta. Sipas tij, ditët e fundit është vërejtur një rënie e këtyre shifrave. "Raportimet zyrtare në këto ditët e fundit flasin se kemi një ulje të rasteve të reja me Covid-19, ulje të hospitalizimeve dhe vdekjeve. Hospitalizimet, nga mbi 900 në fund të muajit mars, në 700 në ditët e fundit. Rastet e rënda me oksigjenoterapi nga 700 deri 750 sa kishim në muajin mars, kanë rënë në 500-550, sipas raportimit në ditët e kaluara. Vdekje me nga mbi dhjetë raste në ditë, në më pak se

dhjetë raste, me njëshifrore në disa ditë radhazi", ka deklaruar Vitia.

Vitia ka thënë se në kohën e tij po bëhen më shumë teste për Covid se në qeverinë e kaluar. "Në 28 ditët e para të kabinetit tonë janë 111 536 të testuar, ndërsa në 20 ditët paraprake ishin 98 140 testime. Për 13.4 për qind janë testuar më shumë në periudhën e fundit", ka deklaruar ai.

Para deputetëve Vitia ka folur edhe për çështjen e sigurimit të vaksinës kundër Covidit. Ai ka thënë se janë në rrugë të mbarë për ta siguruar kontingjentin e dytë të vaksinës përmes COVAX dhe se janë në bisedime me të gjitha kompanitë prodhuese. "Është ngritur një grup punues që po e shikon strategjinë e testimit, po mundëson testimin sa afërt vendbanimeve të qytetarëve. Në procesin e vaksinimit ishin angazhuar 66 ekipe, mungesa

e stafit mjekësor në qendrat e vaksinimit ka qenë sfidë me të cilën jemi përballur", ka thënë Vitia.

Kosova ka nisur procesin e vaksinimit kundër koronavirusit më 29 mars, pas sigurimit të 24 000 dozave të vaksinës "AstraZeneca", përmes programit COVAX të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Gjithashtu, është thënë që Kosova do të pranojë edhe 76 800 doza të tjera të vaksinës së "AstraZeneca" nga ky program në periudhën prill-qershor, ndërsa BE-ja ka bërë me dije se deri në muajin gusht do ta furnizojë Kosovën me 95 000 vakcina kundër koronavirusit të kompanisë "Pfizer/BioNtech", në kuadër të një ndihme për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kosova prej 13 marsit 2020 e deri më 26 prill 2021 ka regjistruar 104 196 raste me Covid-19, 2 140 viktima dhe 91 972 të shëruar.

Edhe 11 të vdekur në Kosovë nga Covidi



PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 1 559 mostra të

marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 154 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar njëmbëdhjetë raste të vdekurve si pasojë e Covidit. Rastet e të vdekurve janë nga

komunat: Gjilan tri raste (92, 80, 66 vjeç), Gjakovë dy raste (76, 72 vjeç), Mitrovicë dy raste (83, 70 vjeç), Drenas një rast (72 vjeç), Pejë një rast (81 vjeç), Prishtinë një rast (73 vjeç), Suharekë një rast (72 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 104 196 raste nga 522 303 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 2 140 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 545 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 91 972 raste, kurse numri i rasteve aktive është 10 084.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 40 raste,

Ferizaj 18 raste, Mitrovicë 16 raste, Pejë 13 raste, Gjilan 10 raste, Gjakovë 9 raste, Obiliq 9 raste, Podujevë 8 raste, Fushë-Kosovë 7 raste, Drenas 5 raste, Vushtrri 5 raste, Lipjan 4 raste, Deçan 2 raste, Prizren 2 raste, Shtime 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash dhe Viti.

Përkujtohet sulmi i parë frontal i UÇK-së kundër policisë serbo-jugosllave në Balincë

MALISHEVË, 26 PRILL (ER) - Nën organizimin e shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është përkujtuar të hënën 23-vjetori i sulmit të parë frontal që luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Njësi "Lumi" dhe nga Njësi "Pëllumi" kishin kryer mbi forcat policore serbe në fshatin Balincë, përkatësisht në aksin rrugor të magjistrales Pejë - Prishtinë.

Rreth këtij sulmi ka folur kryetari i OVL-së, Dega në Malishevë, Metush Kryeziu. "Sot 23 vjet më parë ju bashkëluftëtarë të UÇK-së që jeni prezentë, por edhe të gjithë ata luftëtarë dhe ata që tash janë dëshmorë të atdheut,

po rikujtojmë sulmin e parë frontal të ushtarëve të UÇK-së nga të dyja njësitet ushtarake në mes UÇK-së dhe policisë serbo-jugosllave, ku në këtë sulm të organizuar nga komandantët e UÇK-së, Gani Krasniqi e Isni Kilaj, pas një beteje të ashpër, forcat tona triumfuan përballë policisë serbe, e cila pësoi shkatërrime të automjeteve ushtarake dhe dëme të tjera, kurse nga ana jonë nuk pati dëme, përveç një lëndim të lehtë ushtari Skënder Krasniqi. Prandaj ky sulm ishte dhe do të mbetet sulmi i parë dhe historik i drejtpërdrejtë e frontal në mes të ushtarëve të UÇK-së dhe forcave shtetërore policore serbo-jugosllave", ka thënë Kryeziu.



Dhjetë familje me kushte të rënda në Gjakovë do të bëhen me shtëpi të reja

GJAKOVË, 26 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka bërë me dije se dhjetë familje me kushte të rënda ekonomike do të bëhen me shtëpi të reja. "Jam i lumtur që falë miqve të mirë do të kemi mundësi të krijojmë kushte më të mira për familjet sociale. Këtë mision e nisëm sot me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me Shoqatën Bamirëse 'Jetimat e Ballkanit' e përfaqësuar nga Halil Kastrati", ka bërë me dije kryetari Gjini.

Ai ka thënë se vlera e këtij projekti më shumë se monetare është një përmbushje shpirtërore. "Shuma totale e projektit është 205 000.00 euro nga të cilat Komuna e Gjakovës do të participojë 50 000.00 euro. Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga komisioni i cili do të përzgjidhet nga ana e dy anëtarëve të shoqatës si dhe një anëtar nga



komuna. Gjithçka do të realizohet brenda këtij viti kalendarik. Nuk janë vetëm dhjetë shtëpi. Brenda tyre do të

dëgjojen shumë zëra të lumtur që neve do të na lehtësojnë ndërgjegjen kolektive", ka thënë Gjini.

Inxhinierët e FSK-së fillojnë ndërtimin e urës në Dritan të Drenasit

DRENAS, 26 PRILL (ER) - Me qëllim të mbështetjes së qytetarëve për lehtësim të qarkullimit si dhe sanimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e muajit janar, inxhinierët e regjimentit të xhenios të Gardës Kombëtare të FSK-së të hënën, në fshatin Dritan të Drenasit, kanë filluar operacionin e ndërtimit të urës mobile "Mabey Johnson". Projekti i ndërtimit të urës me

gjatësi prej 36 metrash planifikohet të përfundojë në fund të muajit prill dhe do të realizohet në bashkëpunim me Komunën e Drenasit. Kjo është ura e radhës e ndërtuar pas asaj në Hajnoc të Kamenicës. FSK-ja ka njoftuar se është në gatishmëri të plotë për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile dhe në shërbim maksimal ndaj qytetarëve.



Gjilani po shënon rënie të vazhdueshme të rasteve me Covid-19

GJILAN, 26 PRILL (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan ka mbajtur të hënën takimin e radhës të udhëhequr nga nënkryetari Arbër Ismajli për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit dhe vlerëson se ka një rënie të infeksionit dhe bën thirrje për kujdes maksimal.

Ismajli ka njoftuar se Gjilani aktualisht ka rënie të rasteve aktive dhe po punohet vazhdimisht që sa më pak të

infektuar të ketë në Komunën e Gjilanit dhe kjo, sipas tij, mund të arrihet vetëm me bashkëpunimin maksimal dhe me respektimin e masave mbrojtëse, duke mos u grumbulluar dhe duke mbajtur distancën sociale. "Infeksioni vazhdimisht po shënon rënie dhe në bazë të kësaj duhet që masat mbrojtëse dhe distanca sociale të respektohen edhe më tutje, si e vetmja mënyrë e lehtë që ndihmon në mospërhapjen e

virusit. Sot në të dhënat zyrtare kemi 433 raste aktive, 69 persona janë në hospitalizim", ka thënë nënkryetari Ismajli.

Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 20 121 mostra, 6 223 kanë rezultuar pozitivë, 5 654 janë shëruar, 136 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 433 raste janë aktive dhe të hospitalizuar me Covid janë 69 pacientë.



Haxhiu: Gjatë dy dekadave ka munguar vullneti politik për adresim të krimeve të luftës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 PRILL - Ministrija e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në një diskutim me eksponentë të çështjes së drejtësisë, ambasadorë, përfaqësues të organizatave relevante të drejtësisë, ka theksuar se një nga prioritetet e qeverisë së re, respektivisht Ministrisë së Drejtësisë, është adresimi i krimeve të luftës, duke pasur parasysh faktin se qeveritë e kaluara asnjëherë nuk i kanë trajtuar me prioritet çështjet e krimeve të luftës. "Ndonëse kanë kaluar dy dekada prej kur ka përfunduar lufta në Kosovë, drejtësia ka qenë në shpërputhje me të vërtetën. Gjatë këtyre viteve ka munguar vullneti politik për



adresim të krimeve të luftës, e ky vullnet politik ka reflektuar edhe tek institucionet e drejtësisë", ka thënë ministrija Haxhiu.

Ministrija ka pohuar se adresimi i krimeve të luftës është një sfidë serioze që

kërkon kapacitete shtesë për ta fuqizuar Prokurorinë Speciale. Deri tani janë vetëm katër prokurorë, ndërkohë që numri i lëndëve është jashtëzakonisht i madh, me ç'rast Haxhiu ka theksuar nevojën e domosdoshme për

rritje të stafit që ndihmojnë prokurorët dhe rritjen e numrit të prokurorëve.

Ministrija Haxhiu ka njoftuar edhe për debatin që do të diskutohet në Kuvend rreth projektligjit që adreson krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Ajo ka bërë me dije se para disa viteve ka hyrë në fuqi një vendim me ndryshim në kodin e procedurës penale ku lejonte gjykimet në mungesë për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë dhe shtoi se projektligji i ri do t'ua liroj duart prokurorëve specialë për të mundësuar efikasitetin në punët e tyre.

Ligji është përpiluar në linjë të plotë edhe me praktikën e tjera, sidomos të vendeve të BE-së, që kanë bërë gjykim në mungesë. "Në maj të këtij viti

do të themelohet grupi për hartimin e koncept-dokumentit për themelimin e institucionit për krimet e kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, duke bashkëpunuar në këtë drejtim me përfaqësues të institucioneve, ekspertë të fushave dhe organizatat vendore e ndërkombëtare. Është koha e fundit që Kosova t'i trajtojë seriozisht krimet që janë kryer ndaj popullsisë në periudhën e luftës së fundit dhe nuk ka asnjë shembull si Kosova që ka neglizhuar krimet, prandaj duhet një hetim serioz për të sjellë drejtësi për atë se çfarë ka ndodhur gjatë luftës. Kriminelët duhet të dalin para drejtësisë, e jo të enden lirshëm, kudo që janë", ka deklaruar ministrija Haxhiu.



Themelohet Komiteti Ndërmintrosor për Komplexin Memorial "Adem Jashari"

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 PRILL - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës në të cilën ka miratuar disa vendime nga fushat e përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore. Në këtë mbledhje qeveria ka miratuar vendimin për themelimin e Komitetit Ndërmintrosor për koordinimin e procesit, përzgjedhjen e projektit dhe monitorimin e procesit të implementimit të projektit për Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në këtë përbërje: 1. Albin Kurti, kryeministër i Republikës së Kosovës; 2. Hajrulla Çeku, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit; 3. Liburn Aliu, ministër i Mjedisit,

Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; 4. Rozeta Hajdari, ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; 5. Hekuran Murati, ministër i Financave, Punës dhe Transfereve; 6. Anëtar i Komitetit, përfaqësues nga familja Jashari; 7. Anëtar i Komitetit - drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës; 8. Anëtar i Komitetit - drejtor i Muzeut të Kosovës; 9. Anëtar i Komitetit - drejtorii Institutit të Historisë; 10. Anëtar i Komitetit - drejtor i Institutit Albanologjik; 11. Anëtar i Komitetit - Bekim Jashari, kryetar i Komunitetit të Skenderajt; 12. Anëtar i Komitetit - përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve; dhe 13. Anëtar i Komitetit - Emin

Lati, përfaqësues nga OVL e UÇK-së.

Komiteti Ndërmintrosor obligohet t'i kryejë detyrat e përcaktuara me Ligjin për Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe legjislacionin tjetër përkatës. Kabineti qeveritar në këtë mbledhje ka anuluar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'i propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për kryetarë dhe anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikimet Elektronike. Shfuqizimi i këtij vendimi është bërë për shkak se te përbërja e kryetarit dhe anëtarëve të propozuar në vendimin e shfuqizuar nuk është respektuar kuota e nevojshme gjinore, e

përcaktuar me Ligjin për Barazi Gjinore. Në lidhje me këtë, ligji i lartpërmendur përcakton se: "Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqindësh (50 për qind) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse...".

Qeveria ka miratuar edhe vendimin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave të Reformës së Administratës Publike dhe strukturave përgjegjëse për të koordinuar, monitoruar dhe zbatuar dokumentet strategjike të reformës së administratës publike. Po

ashtu, Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe nismën për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare me Qeverinë e Arabisë Saudite për bashkëpunimin policor. Ministria e Punëve të Brendshme do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për lidhjen e kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja do ta përfshijë bashkëpunimin në luftimin e krimet të organizuar trans kufitar, terrorizmit, prodhimi dhe trafikimi i substancave narkotike, krimeve kibernetike dhe krimet e pornografisë së fëmijëve në internet, krimet ekonomike dhe financiare duke përfshirë shpëlarjen e parave, trafikimin e paligjshëm të automjeteve dhe krimeve të ngjashme.

Kurti: Gjatë mandatit qeverisës do të mundësohet banim i përballeshëm për 4 000 familje

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, si dhe ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, morën pjesë në takimin e Komitetit Këshillues të Projektit (KKP), ku u diskutua rreth studimit të fizibilitetit për Programin e Banimit Social në Kosovë. "Si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës dua t'ju siguroj që qasja jonë në këtë dhe mandatet e tjera do të jetë progresiste. Ta bësh Kosovën të jetëshme do të thotë ta bësh Kosovën të banueshme. Nuk do ta lëmë askënd prapa, nuk do ta lëmë askënd jashtë. Do të sigurojmë banim për të gjithë. Jo vetëm strehim, por banim të dinjitetshëm. Individual e social. Për familjen. Për komunitetin. Për shoqërinë. Për Republikën", ka thënë kryeministri Kurti në hapje të

takimit.

Kurti bëri me dije se gjatë mandatit të parë të qeverisjes do të mundësohet banim i përballeshëm për 4000 familje. Ai ka theksuar se kjo do të arrihet përmes programit "120x120" dhe "150x150", ku familjet përfituese do të bëhen pronare të banesave me këste mujore prej vetëm 120 respektivisht 150 eurove maksimumi dhe për një periudhë kohore prej jo më shumë se 150 muajve. "Kostoja vjetore e këtij projekti është rreth 22 milionë euro, por kjo shumë gradualisht i kthehet institucionit i cili do të themelohet dhe ngarkohet me implementimin e projektit", ka deklaruar Kurti.

Gjatë këtij takimi, në të cilin morën pjesë edhe Ulrika Richardson, koordinatore për zhvillim e Kombeve të Bashkuara, Omar Siddique, udhëheqës i Zyrës dhe kryekëshilltar teknik në UN-Habitat, si dhe përfaqësues të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, u prezantua dhe



diskutua për përparimin e deritashëm, strukturën e detajuar të raportit të studimit të fizibilitetit, si dhe hapat e ardhshëm. Ky ishte takimi i dytë i Komitetit Këshillues të

Projektit për Studimin e Fizibilitetit për Programin e Banimit Social në Kosovë, organizuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

(Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit) e Kosovës, mbështetur nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës dhe UN-Habitat.

Policia, plan operativ për ngritjen e sigurisë në trafik, fokus motoçikletat



PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Policia e rajonit të Prishtinës, respektivisht Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor, duke u mbështetur në vlerësimet e fundit që i ka bërë situatës së sigurisë në trafik, ka ngritur shqetësimet në lidhje me masat që duhen ndërmarrë me qëllim të përmirësimit të treguesve të sigurisë rrugore dhe për uljen e numrit të kundërvajtjeve në trafik.

Me gjithë faktin se policia në vazhdimësi është angazhuar në kontrollin për zbatimin e rregullave të trafikut nga të

gjithë shfrytëzuesit e rrugës, duke synuar uljen e numrit të kundërvajtjeve në trafik dhe ngjarjeve aksidentale, është parë e nevojshme që krahas kontrolleve të strukturave të policisë të punohet edhe në drejtim të ndërgjegjësimit të qytetarëve për respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor. "Mbështetur mbi këtë bazë, në kuadër të shtimit të punës preventive për forcimin e rregullit si dhe disiplinimin e shfrytëzuesve të rrugës, Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor ka filluar

implementimin e një plani operativ për kontrollin e shtuar në trafik me fokus të veçantë ndaj ngasësve të motoçikletave. Vetëm të hënën deri në orën 15:00 janë shqiptuar 129 masa administrative për kundërvajtje të ndryshme në trafikun rrugor ndaj ngasësve të motoçikletave. Ky operacion do të ketë shtrirje në të gjitha rrugët e rajonit të Prishtinës dhe do të vazhdojë derisa të vlerësohet që është arritur efekti i dëshiruar", ka njoftuar Policia e Kosovës.

OAK-u kërkon nga Ministria e Drejtësisë krijimin e Gjykatës Komerciale

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Gjykata komerciale dhe rritja e efikasitetit të gjyqësorit ishin disa ndër temat kryesore në takimin e realizuar ndërmjet përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) dhe zëvendësministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu. Kryetari i Bordit i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skënder Krasniqi, ka përgëzuar zëvendësministrin Sallahu për pozitën, me bindjen që përmes bashkëpunimit të ndërsjellë do të trajtohen dhe zgjidhen

çështjet me interes për komunitetin e biznesit. Ndër të tjera, u theksua që kërkesë urgjente e bizneseve është krijimi i Gjykatës Komerciale, për të cilën duhet që fillimisht të merren parasysh rekomandimet e bizneseve e pastaj të kalojë në Kuvend për miratim, sepse vonesat e trajtimit të lëndëve me të cilat aktualisht po përballen bizneset, përveç që po shkatërrojnë bizneset aktuale, gjithashtu po largojnë edhe investitorët e huaj. Krasniqi ka thënë se është e

nevojshme të krijohet një komisioni profesional brenda Kuvendit të Kosovës, i cili do të kujdeset për harmonizimin e draftligjeve para votimit në Kuvend. Ndërsa sekretari i Bordit i OAK-së, Diamant Elshani, ka kërkuar që të rritet efikasiteti i gjyqësorit ashtu që lëndët ekonomike të trajtohen me prioritet e, gjithashtu, të rritet numri i gjyqtarëve të specializuar dhe të rritet efikasiteti i përmbauesve. Zëvendësministri Sallahu ka përgëzuar OAK-në për punën e realizuar, duke shtuar që



janë të hapur për bashkëpunim, me theks të veçantë te krijimi i gjykatës

komerciale, pasi ky aktualisht është një ndër prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë.

Ministri Aliu dhe ambasadori i Austrisë flasin për projektet mjedisore

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger. Në këtë takim të

dyja palët diskutuan për prioritetet e MMPHI-së si dhe për bashkëpunimin për çështje me interes të përbashkët.

Si çështje kryesore në takim u diskutua për projektet përkatëse që kanë të bëjnë me

zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë si dhe për rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Ministri Aliu e ka falënderuar ambasadorin austriak për mbështetjen

dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm si dhe ka shprehur gatishmërinë e tij për shtimin e bashkëpunimit për projektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.



KEDS-i fillon investimet masive në rrjetin elektrik të Klinës

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

Prishtinë, 26 prill - Kompania për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) po vazhdon investimet në Klinë. Vetëm këtë vit në këtë komunë do të investohen rreth 800 mijë euro në rrjetin elektrik. KEDS-i ka njoftuar se rrjetit i tensionit të ulët dhe të mesëm po rikonstruohet dhe po zëvendësohet me rrjet tërësisht të ri. "Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në shërbime më kualitative të energjisë elektrike për banorët e asaj ane", është thënë në njoftimin e KEDS-it.

Nga këto investime, përpos qendrës së qytetit, ku do të vendoset një stabiliment

tërësisht i ri, do të përfitojnë edhe fshatrat: Kërnicë, Perçevë, Dollc, Leskoc, Restoka, Gjurgjeviku, Sferka, Krusheva e Madhe, Krusheva e Vogël, Gllareva dhe Ujmiri. "Gjendja e rrjetit të vjetërsuar në këto zona ka bërë që konsumatorët në të kaluarën të ballafaqohen me vështirësi të furnizimit kualitativ me energji elektrike. Krahas kësaj, në këto fshatra në vazhdimësi është rritur edhe kërkesa për furnizim duke bërë që trafostacionet ekzistuese shpeshherë të mbingarkohen. Shtyllat e vjetra kanë qenë të vendosura në zona vështirë të qasshme, sikurse në oborre apo fusha derisa me investimet e reja, ato do të barten përkaj rruge", ka njoftuar KEDS.



Përmes planit investiv të KEDS-it, parashihet që përpos vendosjes së trafostacioneve të reja me kapacitete të nevojshme furnizuese, të zëvendësohen edhe qindra shtylla dhe të shtrihen qindra metra kabllo e re.

KEDS-i edhe në të kaluarën ka investuar në rrjetin elektrik të Klinës. Vitin e kaluar kjo kompani ka investuar mbi 170 mijë euro në linjat e tensionit të mesëm dhe të ulët nga të cilat kanë përfituar qindra konsumatorë. "Këto investime tregojnë përkushtimin e kompanisë për përmbushjen e premtimeve dhe vendosmërinë për të qenë sa më afër konsumatorit", ka njoftuar KEDS-i.

BQK-ja e gatshme për bashkëpunim me institucionet financiare në Sllovaki



PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim shefin e Zyrës Ndërlidhëse Sllovaqe në Prishtinë, Rastislav Kostilnik. Guvernatori Mehmeti e ka informuar Kostilnikun me zhvillimet që kanë ndodhur në sektorin financiar dhe angazhimin e BQK-së për tejkalimin sa më të lehtë të situatës nga ndikimet e shkaktuara prej pandemisë. Ai ka përmendur edhe masat që ka ndërmarrë BQK-ja për t'i ndihmuar qytetarët dhe bizneset për tejkalimin më të lehtë të gjendjes së krijuar, si dhe

veprimet për të mbajtur sektorin financiar stabil dhe likuid. Guvernatori Mehmeti ka shprehur gatishmërinë për ta thelluar bashkëpunimin me institucionet financiare në Sllovaki, me qëllim të nxitjes së sektorit financiar për të investuar në vendin tonë.

Nga ana tjetër, shefi i Zyrës Ndërlidhëse Sllovaqe në Prishtinë, Rastislav Kostilnik, ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për pritjen dhe informacionet e ofruara, si dhe ka shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit për çështjet që kanë të bëjnë me sistemin financiar mes dy institucioneve edhe më tutje.

Klubi i Prodhuesve organizon diskutimin 'Rritja e eksportit përmes private label'

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Klubi i Prodhuesve i Kosovës organizon tryezën e diskutimit "Rritja e eksportit përmes private label", e cila mbahet në kuadër të Private Label Network Kosovo.

KPK-ja ka filluar iniciativën e Rrjetit të Etiketave Private, që synon t'i mbështesë, zhvillojë dhe promovojë prodhuesit e etiketave

private. Kjo iniciativë ka për qëllim që t'i familjarizojë prodhuesit e Kosovës me këtë koncept, por edhe ta rrisë eksportin e produkteve vendore duke gjetur tregje të reja për prodhuesit.

Pikërisht kjo nismë do ta bëjë organizimin e konferencës "Rritja e eksportit përmes private label", gjatë së cilës do të

diskutohet mbi çështjet kryesore të private labels, duke përfshirë rëndësinë dhe avantazhet e private labels, strategjitë e rritjes së biznesit përmes private labels dhe bashkëpunimin në mes të prodhuesve, shitësve shumicë/pakicë.

Diskusimi mbahet më 27 prill 2021, me fillim nga ora 10:00 deri në orën 12:00, në "Hotel Nartel" në Prishtinë.



CERN dhe FERMILAB kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës,
që tashmë është zbuluar nga fizikani Naim Krasniqi (2)

Arsyeja e mbetjes së forcës gravitacionale jashtë modelit standard të fizikës së grimcave



Nga: Naim KRASNIQI, fizikan

Nëse orientohemi nga makrobota shihet se universi përbëhet nga materia brenda të cilës hyjnë të gjithë trupat nga më të vegjlit e deri te galaksitë dhe mikrouniversi, duke përfshirë ata të gjendjes së ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, si dhe rreth 95 për qind të një zbrazëtire brenda të cilës gjenden këta trupa qiellorë.

Zbrazëtira që ndodhet brenda këtyre trupave qiellorë, që sot njihet si energjia e zezë konsiderohet si forca e pestë fundamentale e fizikës, që është një forcë repulsive që i kundërvihet forcës tërheqëse në mes trupave qiellorë duke përfshirë edhe galaksitë me ç'rast parandalohet goditja e tyre dhe ruhet stabiliteti i rrotullimit të trupave qiellorë në mbarë hapësirën e universit. Kjo është arsyeja pse modeli standard i fizikës së grimcave ende nuk është kompletuar, edhe përkundër përpjekjeve të pandalura të komunitetit shkencor për zbulimin e kësaj grimce nga e cila formohet kjo forcë repulsive apo forca e pestë fundamentale e fizikës që i kundërvihet forcës tërheqëse në mes trupave qiellorë.

Sa për ta kuptuar më thjeshtë, forca e pestë fundamentale është një forcë repulsive që vepron sikur në mikrobotë ashtu edhe në makrobotë.

Tani le të kthehemi te raportet e

publikuara nga dy qendrat e lartcekura: 1) CERN - The European Organization for Nuclear Research. 2) Fermilab - Fermi National Accelerator Laboratory.

Raporti i parë nga CERN-i, i datës 23 mars 2021

Së pari fillojmë me botimin e parë nga CERN-i lidhur me publikimin e informacionit se: një eksperiment që është zhvilluar në Qendrën Evropiane të Kërkimeve Bërthamore (CERN) The European Organization for Nuclear Research theksohet se po lëkund modelin standard të fizikës së grimcave me zbulimin e një grimce të re apo një interaksion të ri. Më tej theksohet se eksperimenti LHCb studion një lloj grimce të quajtur meson B, që përbehet nga një antiquark bottom/në fund si dhe një quark qoftë up/lart (B+), down/poshtë (B0), strange/ të çuditshëm apo charm/ sharmant.

Në (LHC) që është përplasësi i madh i hadroneve në botë, këto grimca dezintegrohen në tri lloje të grimcave duke përfshirë edhe elektrone dhe muone. Sipas modelit standard të fizikës së grimcave dezintegrimit i mesoneve B duhet të bëhet me probabilitet të njëjtë. Por

sipas eksperimentit në përshpejtuesin (LHC) kemi një dezintegrimit më të madhe të elektroneve se sa të muoneve çka nuk përputhet me modelin standard të fizikës së grimcave. Një dezintegrimit me probabilitet jo të barabartë arrihet vetëm atëherë nëse këtu integrohet një grimcë e re ende e pa parë, apo një interaksion i ri që luan rol të rëndësishëm në mos dezintegrimit e barabartë të muoneve që bien në kundërshtim me modelin standard të fizikës së grimcave.

Rezultati përfundimtar shkencor nga CERN-i

Ne nuk hyjmë në analiza shkencore se si është kryer eksperimenti nga kjo qendër hulumtuuese, sepse ato mund të jenë pjesërisht të publikuara por me rëndësi është se sipas shkencëtarëve të CERN-it nëse vërtetohen këto të dhëna mbi një dezintegrimit jo të barabartë në mes elektroneve dhe muoneve po del se kemi të bëjmë me një grimcë të re apo një interaksion të ri fundamental që ndikon në këtë ndryshim të dezintegrimeve. Kjo bie në kundërshtim me modelin standard të fizikës së grimcave. Prandaj me rëndësi është se këtu kemi të bëjmë me zbulimin e një grimcë të re apo

një interaksion të ri fundamental që nuk e njeh fizika e tanishme por që luan rol në një dezintegrimit më të vogël të muoneve.

Raporti i dytë nga Fermilab, i datës 7 prill 2021

Botimi i dytë ka të bëjë me publikimin nga Fermilab - Fermi National Accelerator Laboratory të ShBA-ve. Është një laborator nacional për kërkime të fizikës së grimcave me energji të lartë në të cilin punojnë rreth 200 shkencëtarë nga të katër anët e botës. Kështu që me datën 07/04/2021 erdhën lajme të reja nga ky laborator me titullin "First results from Fermilab's Muon g-2 experiment strengthen evidence of new physics", që në gjuhën shqipe ka kuptimin "Rezultatet e para nga eksperimenti Fermilab mbi muonin g-2 forcojnë provat e një fizike të re".

Sipas raportit të fizikanëve të këtij laboratorit shkencor thuhet se matjet eksperimentale të vetive magnetike të muoneve ndryshojnë nga të dhënat teorike të bazuara në modelin standard të fizikës së grimcave. Kështu sipas fizikanëve nëse vërtetohen këto rezultate eksperimentale nga institucione të tjera jep për të kuptuar se

mospërputhja e rezultateve eksperimentale të vetitë magnetike të muoneve, me të dhënat teorike të bazuara në modelin standard të fizikës së grimcave, ndodhë për shkak të paraqitjes së një grimce të re apo një force të re fundamentale që vepron në muone. Sipas këtij laboratorit muonet që kanë ngjashmëri me elektronet dhe që kanë një masë rreth 200 here më të madhe se elektronet sillen sikur grimca që në brendësi kanë një minigrimcë magnetike. Në këtë mënyrë muoni ka një moment magnetik anomal që i bie sikur në anomalë.

Rezultati përfundimtar shkencor nga Fermilab

Ngjashëm sikur në rastin e mëparshëm te CERN-it ashtu edhe këtu të raporti i Fermilab nuk hyjmë në detaje se si është kryer eksperimenti por me rëndësi është se sipas shkencëtarëve të laboratorit Fermilab nëse kjo vërtetohet nga institucione të tjera shkencore, se vetitë magnetike të muoneve ndryshojnë nga të dhënat teorike të bazuar në modelin standard të fizikës së grimcave, del se kjo ndodhë për shkak të paraqitjes së një grimce të re apo një interaksion i ri fundamental që vepron te muonet. (Vijon)

Një vit pa më të dashurin tonë



Avni Ahmeti

(20.06.1974-27.04.2020)

(Ish-ushtar e invalid i UÇK-së, i mbijetuar i masakrës së Dubravës)

Vështirë qenka të shkruajmë përkujtimin për ty. U bë një vit pa ty me dhimbje në zemër e lot në sy. Ikën ditët e muajt e u bë viti por mërzia veç sa vjen e shtohet. Sa shumë po na mungon o babi jonë i dashur. Pa ty as jeta s'më duket si ka kuptim, na iku lumturia që dikur e kishim. Mburremi që të patëm baba dhe bashkëshort se meritat tua mbeten çdo kund. Ti gjithmonë do te jesh në zemrat tonë të plagosura. Sa e shkurtër qenka jeta, se gjithmonë e menduam një jetë më të mirë. Por ja ky qenka fati. Sa shumë sakrificën e bëre për lirinë e Kosovës, ushtar u UÇK-së, nëpër burgjet e Serbisë, i plagosur shkove në atë botë, me plumbat e shkaut në trup të cilat i more në burgun e Dubravës, por zoti atëherë të shpëtoi, ndërsa sot nuk ta fali jetën ta gëzosh lirinë, së bashku me familjen tënde.

Të kujtojmë gjithmonë me mall dhe dashuri: bashkëshortja Hata e djemtë Rilindi e Ari.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli dhe Arbëria luftojnë për mbijetesë

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Java e 31-të në Superligën e Kosovës në futboll do të jetë interesante si për luftën për titull ashtu edhe për mbijetesë. Sot (e martë) zhvillohet vetëm një ndeshje, ku Feronikeli në Drenas e pret skuadrën e Arbërisë. Momentalisht "Nikli" është në pozicion më të mirë për faktin se ka 35 pikë të grumbulluara, por mbijetesën ende nuk e ka siguruar dhe në këtë ndeshje do të hyjë për tri pikët e plota. Në anën tjetër, Arbëria, pas fitores kundër Besës në fundjavë, është e motivuar të marrë edhe një tjetër rezultat pozitiv, pasi ka grumbulluar 30 pikë dhe ka shanse të luftojë për mbetjen në elitë. Katër ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të mërkurën. Ballkani e pret në Suharekë skuadrën e Llapit dhe

synim do të ketë marrjen e tri pikëve dhe ruajtjen e pozitës së parë në elitë, të cilën e mori të dielën falë humbjes së Dritës nga Prishtina. Llapi është i koncentruar në finalen e Kupës dhe në këtë ndeshje nuk ka shumë ambicie. Prishtina e supermotivuar pas fitores në derbin e fundjavës, kërkon tri pikët e reja në përballje me Trepçën '89, në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". Kampionia në fuqi, Drita, pasi e humbi pozitën e parë, do të kërkojë t'u rikthehet rezultateve pozitive në ndeshjen ndaj Besës së Pejës, kurse Drenica do të ketë punë me Gjilanin. Kjo e fundit nuk është në garë për titull e as për mbijetesë, prandaj kuqezinjtë do të mundohen të marrin pikë në Gjilan.

SUPERLIGA - java 31

Të martën takohen:
15:00 Feronikeli - Arbëria

Të mërkurën takohen:
15:00 Prishtina - Trepça '89
15:00 Gjilani - Drenica
15:00 Ballkani - Llapi
15:00 Besa - Drita

	Tabela	Pikë
1. Ballkani	30	64
2. Drita	30	64
3. Prishtina	30	63
4. Gjilani	30	43
5. Llapi	30	39
6. Feronikeli	30	35
7. Trepça '89	30	35
8. Drenica	30	34
9. Arbëria	30	30
10. Besa	30	10



Sot ndeshjet e dyta gjysmëfinale të 'play-off'-it

PRISHTINË, 25 PRILL - Të martën do të zhvillohen ndeshjet e dyta gjysmëfinale në "play-off" të FIVE STAR Superligës së Kosovës në basketboll. Edhe në takimet e dyta vendas janë Rahoveci dhe Ponte Prizreni, pasi sistemi në gjysmëfinale është 2-2-1, derisa skuadra që shënon tri fitore do të kualifikohet në finalen e madhe.



Në takimin e parë, Rahoveci, pas një ndeshje dramatike, mundi Golden Eagle Ylli 69:66 dhe do të mundohet ta shënojë fitoren e dytë për të qenë sa më afër finale, derisa therandasi pritët të mobilizohen dhe duan ta fitojnë përballjen e dytë, në mënyrë që ta barazojnë serinë gjysmëfinale, por edhe ta marrin përparësinë e fushës. Peja fitoi në udhëtim takimin e parë ndaj Ponte Prizrenit 92:100 dhe synon ta fitojë edhe përballjen e dytë, kurse prizrenasit janë mobilizuar pas humbjes së parë dhe do ta japin maksimumin për ta barazuar serinë gjysmëfinale.

Ndeshjet e para dhuruan shumë spektakël dhe emocione, e kështu pritët edhe të martën mbrëma.

Dardanët inkuadrohen në Ligën e Parë

Dardanët janë inkuadruar në Ligën e Parë në basketboll te meshkujt. Skuadra nga Klina në ndeshjen e tretë ka shënuar fitore ndaj Boreas 105:65, për të siguruar hyrjen në Ligën e Parë. Dardanët i kishin përfunduar garat e rregullta në

Ligën e Dytë në vendin e parë me 15 fitore dhe tri humbje, derisa tani do të jenë pjesë e Ligës së Parë. Medaljet skuadrave finaliste dhe Kupën kapitenit Altin Buqani i ndan i dërguari i Komisarit i Garave dhe anëtarit i Bordit të ShGJFBK-së, Hajradin Zeka, kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj dhe Alban Rraci.

TË MARTËN TAKOHEN:

17:00 Rahoveci - Golden Eagle Ylli
20:15 Ponte Prizreni - Peja

'Dardanët' të motivuar për ndeshjen ndaj Malit të Zi

PRISHTINË, 25 PRILL - shkak të shëndetit. Në Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll po vazhdon punën për ndeshjen e së mërkurës ndaj Malit të Zi. Faqja zyrtare e FHK-së bën të ditur se hendbollistët janë maksimalisht të motivuar dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të ndeshjes. Selektori Bujar Qerimi nuk ka mundur të udhëtojë nga Belgjika për dy ndeshjet e kësaj jave. Ai pas ndeshjes me Rumaninë doli pozitiv në testin për koronavirus. Ka qëndruar për një kohë i shtrirë në spital dhe tashmë ka marrë veten. Por mjekët ia kanë ndaluar që të udhëtojë nga Belgjika në Kosovë për

shkak të shëndetit. Në mungesë të selektorit, stërvitjet po i udhëheq trajneri i parë Fatmir Muhaxheri. Me portierë po punon Veton Hajrizi. Selektori Qerimi është në koordinim të plotë me shtabin teknik dhe me lojtarët. Komunikimi përmes video-lidhjeve bëhet rregullisht. Muhaxheri është prej emrave të respektuar të hendbollit kosovar, pasi ka udhëhequr Përfaqësuesen U21 në Botërorin e Juniorëve. Tani, në koordinim me selektorin Qerimi, do ta udhëheqë Kombëtaren A në ndeshjen më të rëndësishme deri më tani.

Ministri Çeku: Shtatorja e Vokrrit përurohet më 9 qershor

PRISHTINË, 26 PRILL - Shtatorja e legendës së sportit shqiptar dhe ish-presidentit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, pritët të përurohet në trevjetorin e vdekjes së tij më 9 qershor, por pa parkun e parashikuar pranë stadiumit të qytetit në Prishtinë, i cili mban

emrin e tij. Lajmin e ka konfirmuar të hënën ministri i Sportit, Hajrullah Çeku. Vokrri, njeriu më meritor për pranimin e Kosovës në shtëpitë e futbollit botëror dhe evropian (FIFA dhe UEFA), vdiq tragjikisht në qershor të vitit 2018. "Bazamenti

është ndërtuar, kanë mbetur vetëm disa detaje përfundimtare. Kam kërkuar shpejtim të punimeve dhe jam besimplotë që shtatorja të jetë gati dhe bashkë ta përurojmë më 9 qershor", ka thënë Çeku në seancën parlamentare të Kuvendit të Kosovës.



Cana viziton KOK-in: Jam i gatshëm ta ndihmojë sportin e Kosovës

PRISHTINË, 25 PRILL - Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, ka vizituar sot Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK). Cana është pritur nga

presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe sekretari Shasivar Haxhijaj. Me këtë rast Cana ka uruar Ismet Krasniqin për detyrën e re si presidenti i KOK-

ut duke ia ofruar mbështetjen e tij për ta vazhduar rrugën e ndërkombëtarizimit të sportit të Kosovës. Krasniqi nga ana tjetër e ka falënderuar Canën

për vizitën të cilën e ka konsideruar të veçantë dhe me ç'rast edhe i ka dhënë një dhuratë me portretin e xhudistes Majlinda Kelmendi.



Sonte gjysmëfinalja e parë Real - Chelsea

MADRID, 25 PRILL - Real Madridi dhe Chelsea sonte (e martë) e zhvillojnë ndeshjen e parë gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve në "Alfredo Di Stefano Stadium". Pavarësisht se është raportuar për përjashtimin nga Liga e Kampionëve të këtyre dy skuadrave për shkak të Superligës Evropiane, ndeshja gjysmëfinale do të zhvillohet. "Los Blancos" u kualifikua në gjysmëfinale pasi e mposhti Liverpoolin me rezultat të përgjithshëm 3-1, por në fundjavë skuadra "mbretërore" luajti baras ndaj Real Betisit (0-0). Në anën tjetër ka shtuar shanset për një vend në top-katërshen me fitore minimale që e mori ndaj West Ham Unitedit (1-0).

Trajneri Zinedine Zidane ka thënë se kjo ndeshje nuk është aspak e lehtë për skuadrën e tij. "Është një ndeshje shumë e rëndësishme dhe duam të paraqitemi sa më mirë. Nuk do të jetë aspak e lehtë, pasi Chelsea është një skuadër që sulmon dhe mbron shumë mirë. Duhet të jemi të kujdesshëm në mbrojtje dhe të shfaqemi të rrezikshëm në ofensivë. Duhet versioni më i mirë i Realit. Nuk zgjedhim mes kampionatit dhe Ligës së Kampionëve. Jemi në garë në të dy kompeticionet. Kemi kaluar



Formacionet e mundshme:

Real Madrid: Courtois; Carvajal, Varane, Militao, Nacho; Casemiro, Kroos, Modriq; Asensio, Benzema, Vinicius.

Chelsea: Mendy; Azpilicueta, Silva, Rudiger; James, Jorginho, Kante, Chilwell; Mount, Werner; Havertz.

shumë vështirësi, por ia kemi dalë t'i lëmë pas krahëve problemet e hasura", ka thënë Zidane. Lajme të mira për Realin janë se Eden Hazard, Toni Kroos, Dani Carvajal dhe Raphael Varane janë gati për këtë ndeshje, kurse mungesat janë Federico Valverde, Sergio Ramos, Lucas Vazquez dhe Ferland Mendy. Mungesa e vetme e Chelseat në këtë ndeshje është Mateo Kovaqiq. Për ndeshjen ndaj Real Madridit, foli edhe mbrojtësi i Chelseat, Antonio Rudiger. Mbrojtësi gjerman e ka vlerësuar këtë ndeshje si shumë të komp-

likuar. "Nuk ka duele të lehta në gjysmëfinale. Reali është një kundërshtar i jashtëzakonshëm, por ne po paraqitemi shumë mirë. Mendoj se njerëzit kanë më shumë pritshmëri nga Reali sesa nga ne. Do të jetë një ndeshje shumë e komplikuar. Nuk shoh gjithë ditën futboll, por i kam ndjekur disa ndeshje të Realit, sidomos 'El Clasico'-n ndaj Barcelonës. Ne po e përgatisim ndeshjen ndaj tyre si ndeshja e radhës. E dimë që ata kanë shumë histori në këtë turne, por nuk ka aspak rëndësi një gjë e tillë", ka thënë Rudiger.

Fitojnë Brooklyn dhe Golden State, bie Milwaukee

BROOKLYN, 26 PRILL - Tjetër fitore për Brooklyn Netsin në NBA me skuadrën nju-jorkeze që blindo vendin e parë në Konferencën e Lindjes falë triumfit me shifrat 128-119 ndaj Phoenix Sunsit. Kjo ishte fitorja e 41-të sezonale për Brooklyn Netsin që iu fal paraqitjes mbresëlënëse të dy prej yjeve të skuadrës, Kyrie Irving, i cili shkëlqeu me 34 pikë, 6 rebounde dhe 12 asistime dhe Kevin Durant me 33 pikë. Phoenixit nuk i mjaftuan 34 pikët e realizuara nga Davon Booker. Ruajtja pozitave në zonën "play-off" në Konferencën e Perëndimit Golden State Warriors që mposhti minimalisht me rezultatin 117-



113 ndaj Sacramento Kingsit. Stephen Curry me 37 pikë ishte më i miri mbi parket për Golden State që regjistroi suksesin e 31-të sezonal në 61 takime dhe aktualisht pozicionohet në vendin e 9-të në Perëndim. Surprizon Milwaukee Bucks që u mposht në Georgia nga Atlanta Hawks që po kalon një formë të

shkëlqyer. 111-104 në favor të Atlantës ishte rezultati i sfidës me serbin Bogdan Bogdanović që bëri të harrohej edhe mungesa e yllit të ekipit Trae Young pasi spikati me 32 pikë, ndërkohë që 31 pikë, 14 rebounde dhe 4 asistime të grekut Giannis Antetokounmpo nuk i mjaftuan Milwaukeees për ta evituar humbjen. Vijon rënia e lirë për Orlando Magicun që pësoi humbjen e 11-të në 12 ndeshjet e fundit pasi u mposht edhe nga Indiana Pacersi me rezultatin e thellë 131-112. Kjo ishte fitorja e 4-të rresht për skuadrën nga Indianapolisi që iu fal 24 pikëve, por edhe 8 reboundeve e 9 asistimeve të realizuara nga Brogdoni.

SHKURT

Tri klube në garë për Shaqirin

E ardhmja e Xherdan Shaqirit duket larg Liverpoolit teksa sulmuesi shqiptar po mendon një rikthim në kampionatin italian, aty ku më parë ka luajtur edhe për Interin. Hapësirat e pakta këtë sezon kanë bërë që 29-vjeçari të kërkojë një destinacion tjetër. Sipas "Football Insider", janë dy opsionet nga Italia, ku Roma dhe Lazio janë ekipet që kanë shfaqur interesim për Shaqirin. Opsioni tjetër është Spanja, me Sevillan si një destinacion të mundshëm. Për 29-vjeçarin, Liverpooli kërkon 23 milionë paund, por mund të bëhet dhe ndonjë sakrificë për shkak të krizës ekonomike nga pandemia.

Bayerni arrin marrëveshje me Nagelsmannin

Bayern Muncheni raportohet se ka arritur marrëveshje në parim me Julian Nagelsmann. Tashmë është konfirmuar se Hansi Flick do të largohet nga "bavarezët", shkaku i përplasjes me disa anëtarë të kryesisë. Por, gjermani nuk do të qëndrojë pa punë, pasi lidhet me një kalim të kombëtarja e Gjermanisë, aty ku Joachim Low ka dhënë dorëheqje. Sipas asaj që raporton "Spox", Bayern Munich ka arritur marrëveshje me Nagelsmann dhe është çështje ditësh kur mbyllet marrëveshja. Por, problem mbetet marrëveshja me RB Leipzigun që nuk do ta lëshojë edhe aq lehtë trajnerin. Sipas mediumit, rivali i Bayernit kërkon 30 milionë euro për ta liruar trajnerin nga detyra.

Varane: Jam i përqendruar vetëm te Reali

Raphael Varane ka hedhur poshtë thashethemet se do t'i bashkohet Chelseat gjatë verës, duke këmbëngulur se është i përqendruar vetëm në Real Madrid. Gazeta spanjolle "Mundo Deportivo" ka shkruar të dielën se të kaltrit e kanë kaluar Manchester Unitedin në garë për mbrojtësin francez, por Varane këmbëngul se është 100 për qind i përkushtuar ndaj Realit. "E ardhmja ime është e qartë: përqendrimi i vetëm i imi është në ndeshjet e mbetura të sezonit. Duhet të përqendrohemi në ndeshjet e mbetura. Mesazhi që e kam për tifozët është se unë jam 100 % i përqendruar në ekip", ka thënë Varane.

Simeone: Mentaliteti do të jetë çelësi kryesor për ta fituar La Ligan

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, ka folur pas disfatës nga Athletic Bilbao (2-1) në kuadër të xhiros së 33-të të La Ligas. "Disa ditë më parë më pyetët cili është aspekti kyç i fitimit të ligës. Është e qartë që është mentaliteti. Çelësi i fitores do të jetë balanca emocionale. Kjo humbje ndryshon gjërat, disa ditë më parë nuk perceptohej se do të luanim si pjesën e parë sot. Nuk e dimë çfarë do të ndodhë, por varet nga personaliteti dhe mentaliteti ynë tani e tutje", ka thënë Simeone. "Problemi është se nëse një problem përsëritet, siç është në rastin e pjesës së parë, problemi atëherë është te trajneri. Kur një trajner nuk mund ta zgjidhë një situatë, diçka po shkon keq. Do të tentojmë të përmirësohemi", ka shtuar Simeone.

Griezmann: Titulli, në duar të Barçës

Barcelona arriti një fitore shumë të rëndësishme ndaj Villarealit (1-2). Ishte Antoine Griezmann heroi për katalanasit falë dygolëshit të tij dhe tashmë ata e shikojnë veten më afër me vendin e parë se kurrë. Për këtë

fakt edhe sulmuesi francez është shumë i lumtur si dhe thekson se ata e kanë gjithçka në dorën e tyre për t'u shpallur kampionë. "Të gjithë duan ta fitojnë La Ligan. Janë katër skuadra që po luftojnë dhe po japin

maksimumin. Nuk do të jetë aspak e lehtë deri në fund, por ne e kemi ekipin për të arritur këtë qëllim. Favoritët për titullin janë gjithmonë ata që janë në krye të tabelës. Atletico po kalon një sezon të

pabesueshëm dhe ne po bëjmë më të mirën tonë që në fund të jemi në kampionët. Gjithçka është në dorën tonë. Ne thjesht duhet t'i fitojmë ndeshjet e mbetura", ka thënë sulmuesi francez.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, të nenit 3, paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit për procedurat e përfitimt nga programet e veçanta të banimit, dhe të nenit 4, paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr.23/2010, për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit-Komuna e Malishevës, në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kritereve për sigurimin e banimit familjar për **familjet me gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike**, me ndihmën e Programit të veçantë të banimit në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, jep banesa me qira joprofitabile për periudhën kohore të caktuar sipas marrëveshjes, Drejtoria e Shërbimeve Publike bënë shpalljen publike të:

KONKURSI

Komuna ka siguruar Program të veçantë banimit për **familjet në gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike**, që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, duke ndarë banesa me qira joprofitabile për të krijuar kushte të të përshtatshme për banim normal.

- Kanë të drejtë të jenë përfitues të këtij programi familjet që:

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
2. Kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë lutës së fundit në Kosovë;
3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

- Përcaktimi i personave/familjeve përfituese bëhet mbi bazën e kritereve të përparësisë si vijon:

- a. Statusi i banimit;
- b. Lartësia e të ardhurave;
- c. Gjendja shëndetësore;
- d. Invaliditeti i pjestarëve të familjes dhe
- e. Struktura familjare.

- Kriteret shtesë janë:

- a. Familja e kryesuar nga një prind/prindi vetushqyes dhe
- b. Familja që ka në mbikëqyrje/përkujdesje fëmijët jetim.

- Familjet që bëjnë kërkesë për të përfituar nga ky program i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të komunës së Malishevës.

- Për zgjedhjen e përfituesve nga programi i veçantë i banimit, përparësi kanë familjet me numër më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlersimit të përcaktuar në shtojcën 1 të "Udhëzimit administrativ nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit".

- Në rast se aplikuesit pas vlersimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve, atëherë përparësi do të kenë familjet me më shumë anëtarë" (sipas nenit 5, paragrafi 4, të Udhëzimit administrativ nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit).

- Komuna dhe MPMS si investitore, ka në dispozicion për këtë program të veçantë të banimit objektin banesore nr.02 të ndërtuar në Malishevë rruga "Hamdi Berisha", me 44 (katërdhjetë e katër) njësi/banesa, të cilat i jep me qira joprofitabile për kategoritë me gjendje të rëndë sociale ekonomike dhe të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

- Organi komunal kompetent bënë shpërndarjen e aplikacioneve pa pagesë, në formë standarte, për të gjithë aplikuesit e interesuar, ndërkaq të gjithë aplikuesit të njëjtat mund të marrin në: **Zyrën për pritjen e palëve në objektin e ri të KK-Malishevë, çdo ditë pune prej orës 8:00 h deri në orën 16:00 h.**

- Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës-kopje për aplikuesin dhe gjithë antarët e familjes mbi moshën 16 vjeçe;
2. Vërtetimin se familja nuk ka pasuri të paluajtshme, banesë/shtëpi në vendin /komunën e origjinës prej nga vjen aplikuesi;
3. Nëse aplikuesi/familja është me qira –Kontrata e qirasë, e vërtetuar nga noteri;
4. Certifikata e kadastrës për token/pasurinë e paluajtshme-e paraqitësit të kërkesës dhe antarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe /ose kujdestarëve;
5. Vërtetimin nga organi komunal i tatimit mbi prone, e paraqitësit të kërkesës dhe antarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe /ose kujdestarëve;
6. Vërtetimi se personi/familja është shfrytëzuese e ndihmës sociale-fotokopje kartela sociale me afate vlefshmërie;
7. Vërtetimi nga Ministria e Tregtisë dhe industrisë që aplikuesi apo ndonjëri nga antarët e familjes së tij nuk kryejnë aktivitet tregtarë (nuk kanë biznes);
8. Vërtetimi nga Departamenti i Punësimit (Enti i punësimit) për të gjithë antarët e familjes mbi 18 vjeçe të cilët janë si kërkues pune, por që nuk janë të punësuar;
9. Vërtetimi punësimi nga punëdhënësi për çdo pjestarë të familjes i cili është i punësuar në Institucionet shtetërore apo Sektorin privat, ku cilësohet pozicioni i punës dhe paga e fituar (neto);
10. Vërtetimi nga organet kompetente i cili deklaron të ardhurat për personat të cilët janë në pension-Vendimi (origjinale);
11. Vendimet e pensioneve të personave me aftësi të kufizuar (PPAK) nga MPMS-ja për anëtarët e familjes, duhet të jenë me afatë të vlefshëm;
12. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës që (nuk punon) për aplikuesin dhe antarët e familjes që janë 18 vjeç e më tepër.
13. Dëshmia mbi gjendjen e llogarisë bankare për ekonomizim në Kosovë për 12 (dymbdhjetë) muajt e fundit për aplikuesin dhe antarëve të punësuar në familje;
14. Familjet me sëmundje të rënda kronike dhe me probleme të përhershme shëndetësore-Të dhënat mbi këtë gjendje serioze shëndetësore të aplikuesit apo të antarëve të tjerë duhet të dokumentohet me vërtetim nga mjeku specialist ose komisioni i mjekësisë, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi;
15. Certifikata e mjekut për aftësinë e kufizuar-të aplikuesit ose e antarëve të tjerë të familjes, nëse parashtrusi i kërkesës apo pjesëtari i tjetër i familjes paraqesin kërkesën në baza të aftësisë së përhershme të kufizuar;
16. Dëshmi apo vërtetim mbi përcaktimin e shkallës së invaliditetit-gjendje e vërtetuar sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi;
17. Certifikata apo deklarata e bashkësisë familjare;
18. Certifikata e lindjes-për të gjithë antarët e familjes;
19. Ekstrati i lindjes-vetëm për aplikuesin;
20. Vërtetimi mbi vendbanimin e përhershëm;

21. Çdo aplikues duhet të jetë banorë i komunës së Malishevës së paku 5 (pesë) vjet para kohës së aplikimit-kjo vlen për personat e ardhur nga komunat tjera-të dëshmohe me dokumente relevante për këtë qëllim, p.sh. fletë shpërngullja nga komuna e ardhur;
22. Vërtetim nga shkolla-për fëmijët nga mosha 6-18 vjeç dhe 18-25 vjeç, të cilët janë në shkollim (universitet).
23. Certifikata e kurorëzimit-për personat e martuar në familje, posaçërisht për bashkëshortin/bashkëshorten e aplikuesit, nëse ai person është i përfshirë në kërkesën e paraqitur;
24. Certifikata e shkurorezimit, në rastin e çifteve të divorcuara që kanë një apo më tepër fëmijë në mbikëqyrje/përkujdesje prindërore-të dëshmohe me vendim gjyqësor për mbikëqyrjen/përkujdesin prindëror të fëmijës apo fëmijëve (origjinali ose i vërtetuar tek noteri);
25. Familja e cila ka në mbikëqyrje dhe përkujdesje fëmijë/fëmijët jetimë-dëshmohe kujdestaria me vendim nga autoriteti kompetent;
26. Të gjitha dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj nga dita e lëshimit të tyre;
27. Nëse ekziston arsyeja, do të kërkohen edhe dokumente të tjera shtesë;

- **Kërkesa e plotësura dhe dokumentacioni i nevojshëm dorëzohen dhe pranohen në Komunë në Zyrën për pritjen e palëve në objektin e ri të KK-Malishevë çdo ditë pune.**
- Konkursi mbetet i hapur **30 (tridhjetë) ditë** nga dita e shpalljes publike në njërën nga gazetatat e përditëshme, duke filluar prej dt: _____ deri me dt: _____, ndërsa raporti dhe dokumentacioni i kompletuar i përcillet komisionit vlerësues brenda 5 (pesë) ditësh.
- Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e familjeve bën shqyrtimin e gjendjes së banimit dhe të dhënave të tjera të nevojshme të aplikueseve brenda **30 (tridhjetë) ditëve, ndërkaq brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasuese do të bëjë vlerësimin dhe verifikimin në terren të parashtrusit të kërkesës.**
- Aplikacionet e dorëzura pas afatit kohor, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen të pavlefshme.
- Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për tu kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të banimit social.
- Ndalohet bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.
- Komuna në tabelën e shpalljeve do të publikojë listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
- Kohëzgjatja e përfitimt nga programi i veçantë për banim është **3 (tre) vite**.
- Pas shpalljes së listës, familjeve të renditura sipas pikëve të fituara dhe kundër Vendimit të Komisionit vlerësues, pala e pakënaqur mund të parashtrorë ankesë me shkrim brenda **30 (tridhjetë) ditëve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-MMPH**, nga dita e pranimit të Vendimit.

Për informata shtesë ju mund të paraqiti tek Drejtoria e DSHP.

Drejtoria e DSHP:

Milazim Morina

Njoftim për mbrojtjen publike të punimit të doktoratës

Njoftohen të interesuarit se me datë 07.05. 2021 (e premte) në orën 17.00, në Sallën e Profesorëve të Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, kandidatja Safete Hadergjonaj do të bëjë mbrojtjen publike të Punimit të Doktoratës me titull "Zëvendësimi i importeve të produkteve bujqësore prioritet i zhvillimit ekonomik në Kosovë".

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Leutrim Hoxha shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt " 11 Marsi " Prizren.
- ▶ Herolind Collaku shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën dhe diplomën shmlt " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Mark Baftijari BI shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit 811041665 Prizren.
- ▶ Fatmir Ymeraj shpall të pavlefshme dëftesat shfmu " Hysni Temaj " Prizren.
- ▶ Arber Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Avdyl Frashi " Prizren.
- ▶ Drilon Badalli shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.
- ▶ Halit Ramadani shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt " 11 Marsi " Prizren.
- ▶ "Austria Praemix Kosova" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811513242 si dhe nr. 330474495.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





Hysen Beqa lindi në Mollë të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë pikëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijon shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

Albin Mehmeti

5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!

Unë jam gruaja më e fortë në botë!



6.99€



UNË, KUFOMA E ARDHSHME

Kaltrina Pacolli

